



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Agro Invest 1" Sh.P.K. të datës 24.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.09.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "121 Pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimit atmosferik lot 4" me nr. të prokurimit 616-24-4344-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Agro Invest 1" Sh.P.K. të datës 24.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.09.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "121 Pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimit atmosferik lot 4" me nr. të prokurimit 616-24-4344-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Agro Invest 1" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 24.09.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.09.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "121 Pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimit atmosferik lot 4" me nr. të prokurimit 616-24-4344-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - "1. Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik me më se paku tre vite përvojë pune pas diplomimit per llot I,II,III dhe llot IV dhe si deshmi eshte kerkuar Diplomë universitare - Kopje e Noterizuar; Biografia (CV-në) Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; Grupi OE ka dorezuar ing. Avni Lohaj i cili nuk e ka te nenshkruar CV-ne (faktet te bashkangjitura ne attach)".

Pretendimi nr. 2 - "2. Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: Puntorë fizik 5(pesë) per llot I,II,III dhe llot IV ku si deshmi eshte kerkuar Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; Grupi OE ka dorezuar vetem nje liste te punetoreve teknik ku mungojne kontratat ose parakontratat me punetoret (faktet te bashkangjitura ne attach)".

Pretendimi nr. 3 - "3. Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: për llot IV LLOTO 4 Eskavator 4x4, me lugë ngarkuese para dhe mbrapa. Grupi OE ka dorzuar nje list te pergjithshme te makinerise jo specifiket per kete tender, gjithashtu ka dorzuar eskavator te cilet nuk kan lug ngarkuese para dhe mbrapa dhe nuk jane 4x4 pra jane eskavatore te thjeshte dhe jo sic eshte kerkuar ne FTD (faktet te bashkangjitura ne attach)".

Lidhur me pretendimet ankimore, me rastin e rivlerësimit komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar në kuptim të nenit 72 të LPP. Pas pranimit të sqarimeve shtesë, komisioni vlerësues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi për pajisjen eskavator 4x4 i cili nuk është i thjeshtë por me lugë ngarkuese para dhe mbrapa. Po ashtu janë dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara dokumentare për punëtorët fizik por edhe për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.09.2024


Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.